

VENDIM
Nr. 486, datë 11.6.2013

PËR PJESËMARRJEN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, ME PUNONJËS TË POLICISË SË SHTETIT, NË MISIONIN E FORCAVE TË NDIHMËS DHE SIGURISË NDËRKOMBËTARE “ISAF”, NË AFGANISTAN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 5 të ligjit nr. 10 438, datë 28.6.2011 “Për pjesëmarrjen e Policisë së Shtetit në misione policore paqeruajtëse dhe humanitare jashtë vendit”, të nenit 47 të ligjit nr. 9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13 të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dërgimin e një grupi ekspertësh nga Policia e Shtetit, në kuadër të kontributit të NATO-s, në Afganistan, si pjesë përbërëse e misionit trajnues, në kuadrin e operacionit “ISAF” të NATO-s, në Afganistan.

2. Grupi i ekspertëve të Policisë së Shtetit, që dërgohet në këtë mision, të përbëhet nga 11 (njëmbëdhjetë) punonjës policie.

3. Misioni dhe detyrat e punonjësve të Policisë së Shtetit janë të trajtojnë dhe të këshillojnë punonjësit e Policisë Afgane në Komandën Rajonale Perëndimore (RC-W), pranë Policisë Kombëtare Afgane (ANP), Provinca Herat-Afganistan, me qëllim zhvillimin e një force policore afgane të pavarur dhe profesionale.

4. Transporti strategjik është përgjegjësi e palës shqiptare dhe italiane, e cila rregullohet nga marrëveshja teknike, ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Italisë, për mbështetjen logjistike të bazës së avancuar mbështetëse të Heratit dhe të Komandës Rajonale të Perëndimit në territorin e Afganistanit.

5. Kohëzgjatja e këtij misioni është 6 (gjashtë) muaj, afat i cili fillon nga data e dërgimit të grupit në Afganistan.

6. Ministria e Brendshme të përballojë për pjesëmarrësit në këtë mision shpenzimet për:

a) shpërblimin që marrin punonjësit e policisë për vështirësi shërbimi, në masën 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë në ditë, përveç pagës mujore;

b) sigurimin e jetës;

c) shërbimet telefonike dhe postare;

ç) transportimin e punonjësit të policisë për në atdhe, në raste vdekjesh, sëmundjesh dhe thyerjesh disiplinore;

d) aktivitetet social-kulturore dhe festat kombëtare;

dh) çdo shpenzim tjetër për mbarëvajtjen e operacionit.

7. Policia e Shtetit, në bashkëpunim me INSIG sh.a., të bëjë sigurimin e jetës nga aksidentet të punonjësve të Policisë së Shtetit të Republikës së Shqipërisë që do të marrin pjesë në këtë mision, për shumën totale të përfitimit nga siguri i jetës në masën 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë, për çdo punonjës policie.

8. Efektet financiare, të ndara përkatësisht, në shumën 26 450 (njëzet e gjashtë mijë e katërqind e pesëdhjetë) lekë, të përballohen nga Policia e Shtetit dhe në shumën 22 000 (njëzet e dy mijë) lekë, nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.

9. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha